

VENDIM
Nr. 334, datë 16.5.2012

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR SHKOZET-DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Shkozet-Durrës.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për tokë arë me sipërfaqe 2 548 (dy mijë e pesëqind e dyzet e tetë) m², vlerësuar me çmimin 3600 (tre mijë e gjashtëqind) lekë për m², me një vlerë të përgjithshme prej 9 172 800 (nëntë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind) lekësh.

3. Shuma totale e shpronësimit, prej 9 172 800 (nëntë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind) lekësh, të përballohet nga zëri “Investime”, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, për vitin 2012.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 473 000 (katërqind e shtatëdhjetë e tre mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Shpronësimi të fillojë në datën 16.5.2012.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve të fillojë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimeve, që do t’i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha